



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT

Nr. 7212 prot.

Tiranë, më 19.11.2021

REKOMANDIME
MBI
PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA GJATË HARTIMIT TË FORMULARIT
STANDARD TË PLANIT TË ZBATIMIT TË KONTRATËS

Drejtuar: Autoriteteve/Enteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në ushtrim të kompetencave të saj, në zbatim të nenit 23, gërma "ç" dhe "dh" si dhe pikës 2, të nenit 124 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (në vijim "LPP"), për dhënien e këshillave dhe asistencës në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik si dhe funksioneve monitoruese në drejtim të zbatimit të kontratës, duke u nisur nga formularët standardë të planit të zbatimit të kontratave të dërguar nga autoritetet kontraktore, në adresën elektronike monitorimi.kontratat@app.gov.al dhe në rrugë shkresore, rekomandon si më poshtë vijon:

1. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për zbatimin e kontratës së nënshkruar, sipas kushteve kontraktuale. Gjatë planifikimit të zbatimit të kontratës autoriteti/enti kontraktor në bashkëpunim me kontraktorin, duhet të parashikojë rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë fazës së zbatimit dhe që mund të bëhen shkak për mosrealizimin në kohën, cilësinë dhe koston e parashikuar të kontratës, të tilla siç mund të jenë: *pandemia Covid-19, kushtet atmosferike të stinës, si dhe shkaqe të tjera në varësi të objektit të kontratës që do të zbatohet.*

Duke evidentuar rreziqet e mundshme, autoriteti/enti kontraktor në bashkëpunim me kontraktorin, që në fazën e planifikimit të zbatimit të kontratës, merr masat paraprake për të shmangur moszbatimin e saj sipas kushteve kontraktuale të nënshkruara, në rast se rreziqet e parashikuara shfaqen gjatë fazës së zbatimit të kontratës.

Në lidhje me Pikën B.3, të Seksionit II (*Masat e marra për rreziqet gjatë zbatimit të kontratës*) të planit të zbatimit të kontratës, sqarojmë mënyrën e plotësimit të çdo elementi të tabelës përkatëse të vlerësimit të rrezikut, si vijon:

- **Ngjarja** (Si ngjarje e mundshme gjatë zbatimit të një kontrate, mund të klasifikohet: *pandemia Covid-19, kushtet atmosferike, temperaturat e ulta, rreshjet, ngricat, bllokim rruge, mos vënia në dispozicion e lejeve të ndërtimit, etj.*).

- **Rreziku** (Nisur nga përcaktimi i ngjarjes, plotësohet njëri nga llojet e rrezikut të përcaktuar në tabelë, psh. *i ulët, kritik, i lartë, etj.*).

- **Ndikimi** (Referuar parashikimit të llojit të rrezikut, citohet në tabelë ndikimi që mund të sjellë ai, në zbatimin e kontratës psh, *i ulët, kritik, i lartë, etj.*).

- **Mundësitë** (Në varësi të elementëve pararendës citohet situata/t e mundshme që mund të shkaktojë rreziku i parashikuar si psh. *vonesë në fillimin e zbatimit të kontratës, realizim i pjesshëm i kontratës, mosrealizim i kontratës sipas kushteve kontraktuale, mos sigurimi në kohë i lejes së ndërtimit, dëmtim i mallrave objekt i kontratës etj.*).

- **Vlerësimi i rrezikut** (Parashikohet sipas cilësimeve në tabelën e rrezikut psh: *i ulët, i lartë, etj.*).

- **Masat për zbutjen e rrezikut** (Në pamundësi të shmangies së plotë të rrezikut, citohen masat paraprake të parashikuara për zbutjen dhe minimizimin e efekteve, në rastin e shfaqjes së rrezikut).

- **Afati kohor** (Përcaktohet afati kohor (*orë, ditë, javë etj.*), mbi masat e marra për minimizimin e rrezikut të mundshëm).

- **Përgjegjësitë** (Në tabelë përcaktohen personi/at përgjegjës ose grupi i punës i autoritetit kontraktor dhe kontraktuesit, që janë ngarkuar me përgjegjësinë për të implementuar masat e parashikuara gjatë planifikimit të zbatimit të kontratës, për zbutjen e rreziqeve në momentin e shfaqjes së tyre gjatë realizimit të kontratës).

- **Vërejtje** (Mund të citohet çdo informacion tjetër i nevojshëm, i cili nuk është parashikuar në elementët e mësipërm të tabelës së vlerësimit të rrezikut, gjatë zbatimit të kontratës).

2. Nisur nga fakti se, në disa raste plani i zbatimit të kontratës, dërgohet nga autoritetet kontraktore *me mangësi në seksionet respektive të formularit, pa numër protokoll, pa datë, i pa nënshkruar nga palët kontraktuese, etj.* APP sjell në vëmendje se, formulari standard i planit të zbatimit të kontratës, nga ana përmbajtësore duhet të jetë i plotë, pa mangësi sipas të dhënave të secilit seksion respektiv dhe nga ana formale duhet të ketë elementët e nevojshëm si: *nënshkrimi i palëve, i protokolluar, etj.*

3. Plani i zbatimit të kontratës hartohet gjithashtu, për çdo procedurë prokurimi të blerjeve me vlerë të vogël, të cilat janë finalizuar me lidhjen dhe nënshkrimin e kontratës ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe operatorit ekonomik.

4. Gjithashtu, APP sjell në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore, respektimin e afateve ligjore të parashikuara në pikën 3, të nenit 124 të LPP, ku përcaktohet se: *“Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj”* dhe në pikën 1, të nenit 125 të LPP, ku përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor njofton Agjencinë e Prokurimit Publik për nënshkrimin e planit të zbatimit brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij”*.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta